

QZHK - Qendra për Zhvillim të Karrierës e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina“ është njësi e Zyrës për Zhvillim Akademik.

Misioni i QZHK-së është t’u ofrojë studentëve mundësi për zhvillim personal dhe profesional përmes informimit, këshillimit, trajnimit, ndërmjetësimit më punëdhënësin, hartimit të dokumenteve profesionale në fushën e karrierës dhe udhëzimit në karrierë.

Përfituesit e shërbimeve të QZHK-së janë: studentët dhe të diplomuarit e UPHP-së, nxënësit e shkollave të mesme të cilët kërkojnë mundësi studimi në Universitetin e Prishtinës, fakultetet, organizatat dhe punëdhënësit.

Qëllimi kryesor i Qendrës për Zhvillim të Karrierës është përgatitja e studentëve dhe të diplomuarve për tregun e punës përmes këshillimit dhe trajnimeve si dhe përmes informimit të tyre për mundësi të ndryshme të zhvillimit në karrierë.

Përmes platformës virtuale të QZHK së pvk.uni-pr.edu ju mund të:

- Informoheni,
- Këshilloheni,
- Trajnoheni,
- Të ndërtoni urat me tregun e punës;

Kalendari i aktiviteteve javore në QZHK

E hënë, e martë, e mërkurë- trajnimet për studentë (trainings)/ një javë në muaj

E premte – testi i arritshmërisë pas mbajtjes së trajnimeve;

E mërkurë - Video sesionet/ dy herë në muaj

Çdo të enjte- Këshilla rreth përgatitjes së CV-së dhe letrës motivuese (CV and cover letter checking) me caktim të terminit; Orari i konsultimeve (09:00 – 12:00)

Cdo të premte – Këshilla rreth përgatitjes për intervistë pune (job interview tips) me caktim të terminit; Orari i konsultimeve (09:00 – 12:00);

Kalendari i aktiviteteve mujore në QZHK

KALENDARI I AKTIVITETEVE 2016

MUAJ

JANAR 2016

AKTIVITETI

“Informohu përmes këndeve informuese të QZHK-së në fakultete”

SHKURT 2016

“Vizita e studentëve në kompani të ndryshme”;

MARS 2016

“Shkëmbe përvojën- ndihmo të tjerët;

PRILL 2016

“Kupto për mundësitë e angazhimit në tregun e punës”

MAJ 2016

Panairi Virtual i Karrierës

QERSHOR 2016

“Kupto më tepër rreth testeve kualifikuese për programet e mobilitetit”;

KORRIK 2016

“Njohja me përvojat e studimeve jashtë vendit”

SHTATOR 2016

“Zbullo të ardhmen e profesionit tënd”

TETOR 2016

“Ditët e Orientimit”

NËNTOR 2016

“Kuizi për karrierën”;

DHJETOR 2016

“Rrëfimi për karrierën time”

Modulet trajnuese në QZHK

Qendra për Zhvillim të Karrierës Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina“

MODULI I	TRAJNIME QZHK - UPHP			
	TEMAT	Sesioni I	Sesioni II	Sesioni III
MODULI II		Si t'i qasemi tregut të punës;	Përgatitja e CV-së dhe letrës motivuese;	Përgatitja për intervistë të punës;
	TEMAT	Sesioni I Shkathtësitë e nevojshme për punësim më të lehtë – Shitja;	Sesioni II Shkathtësitë e komunikimit;	Sesioni III Shkathtësitë e prezantimit;
MODULI III				Përpilimi i një projekt plani;
	TEMAT	Sesioni I Analiza SWOT dhe TOWS ;	Sesioni II Hulumtimi i tregut - Përpilimi i pyetësorve;	Sesioni III

Aplikimi online përmes emailit zyrtar: qzhk@uni-pr.edu ose direkt në Qendrën për Zhvillim të Karrierës - Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina“

Adresa: Biblioteka Kombëtare e Kosovës / Kati i I-rë